



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori e thelluar

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	C	D	A	C	D	B	A	C	A	C

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11

Model përgjigjeje

- Pozicioni gjeografik për shkak të largësisë së madhe nga Britania e bënte më të vështirë mbajtjen nën kontroll të kolonive, ndërkohë që nxiste dëshirën e tyre për të qenë të pavarur.
- Legjislaturat koloniale. Kolonitë bazoheshin në modelin e vetëqeverisjes të pavarura nga kurora mbretërore.
- Përqafimi i gjerë i ideve iluministe që shërbyen si model për zhvillimin e qeverisjes demokratike të kolonive amerikane.
- Përpjekjet britanike për të rritur presionin fiskal (taksat) sidomos për shkak të shpenzimeve të mëdha të Luftës Shtatëvjeçare. Kolonitë nuk pranonin që taksat të përcaktoheshin nga parlamenti britanik ku ata nuk kishin përfaqësues (“taksat pa përfaqësim”).
- Devijimi nga parimi merkantilist bëri që kolonitë të zhvillonin tregtinë e lirë midis tyre.

3 pikë Nëse shpjegon tre nga arsyet.

OSE

2 pikë Nëse shpjegon dy nga arsyet.

1 pikë Nëse shpjegon një nga arsyet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**Model përgjigjeje**

- Lidhjeve martesore vetë Skënderbeu u martua me të bijën e Gjergj Aranitit, vëllai i të cilit kishte marrë për grua motrën e Skënderbeut. Mamica u martua ne derën e Topiajve.
- Vullnetarizmit të feudalëve që besonin te Skënderbeu dhe ishin të gatshëm të luftonin nën drejtimin e tij.
- Forcës për t'i bindur ose detyruar feudalët ta pranonin krijimin e shtetit si një nevojë për të përballuar ushtrinë osmane.

3 pikë Nëse shkruan tri nga mënyrat që përdori Skënderbeu.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga mënyrat që përdori Skënderbeu.

1 pikë Nëse shkruan një nga mënyrat që përdori Skënderbeu.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**Model përgjigjeje**

Reformat e ndërmarra me synimin për të përmirësuar sistemin nxorën në pah dobësi të mëdha në të gjitha fushat.

- Administrimi i trashëguar nga e kaluara nuk mund të përshtatej me kërkesat e ekonomisë së tregut.
- Teknikat e prodhimit ishin të prapambetura.
- U rishfaqën problemet nacionaliste të kombësive jo ruse.
- U shfaqën kërkesat për pavarësi.
- Reformat hasën në kundërshtime si nga forcat konservatore (që i kundërshtonin ato) po ashtu edhe nga radikalët (që kërkonin më shumë dhe ritëm më të shpejtë për to).

3 pikë Nëse jep tre nga arsyet pse reformat nuk rezultuan të suksesshme.

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga arsyet pse reformat nuk rezultuan të suksesshme.

1 pikë Nëse jep një nga arsyet pse reformat nuk rezultuan të suksesshme.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**Model përgjigjeje**

- Perandori kishte autoritet të kufizuar dhe nuk mund të shtrinte autoritet mbi daimiot.
- U ruajtën tiparet e ekonomisë dhe shoqërisë feudale.
- Daimiot (pronarët e mëdhenj të tokave) ushtronin pushtetin e vërtetë në krahinat ku kishin zotërimet e tyre.
- U forcua shtresa e samurajëve.

3 pikë Nëse shkruan tri veçoritë e zhvillimit të Japonisë në atë periudhë.

OSE

2 pikë Nëse shkruan tri veçoritë e zhvillimit të Japonisë në atë periudhë.

1 pikë Nëse shkruan tri veçoritë e zhvillimit të Japonisë në atë periudhë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

- Mbështetja e pamjaftueshme financiare nga Fuqitë e Mëdha.
- Kristalizimi i qëndrimeve të kundërta brenda qeverisë.
- Kontradiktat mes vete Fuqive të Mëdha në prag të Luftës I Botërore (shprehur edhe në përplasjet mes anëtarëve të KNK).
- Dalja e KNK nga roli kontrollues dhe ndërhyrja e tij në qeverisje.
- Vështirësitë e shkaktuara nga lëvizja vorio – epirote.
- Kryengritja e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme.
- Mosnjohja e realitetit shqiptar nga ana e Vidit.
- Fillimi i Luftës I Botërore.


3 pikë Nëse jep tre nga arsyet e largimit të Vidit.

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga arsyet e largimit të Vidit.

1 pikë Nëse jep një nga arsyet e largimit të Vidit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16**Model përgjigjeje**

Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
Mbështetnin perandorin me hua, para e ushtarë	Në të dy tipet e qyteteve, i paguheshin para qoftë perandorit, qoftë sinjorit feudal për te garantuar mbrojtjen	Qytetet kishin të drejtën e vetëqeverisjes
Siguronin mbrojtjen e perandorit		Paguanin sinjorit feudal një takse vjetore
U zhvilluan në Gjermani		U zhvilluan në Francë dhe Angli

3 pikë Nëse jep dy tipare dalluese dhe një të përbashkët

OSE

2 pikë Nëse jep një tipar dalluese dhe një të përbashkët **OSE** dy tipare dalluese

1 pikë Nëse jep një tipare dalluese **OSE** një të përbashkët

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 17**Model përgjigjeje**

- E drejta e indianëve për të zënë poste të larta në qeveri.
- Marrja e masave për zhvillimin e industrisë vendase.
- Zhvillimi i arsimit të përgjithshëm e të lirë për të gjithë fëmijët indianë si edhe hapja e shkollave të arsimit tekniko – profesional.
- Pakësimi i shpenzimeve ushtarake.

3 pikë Nëse rendit tre nga kërkesat e Kongresit Kombëtar të Indisë.

OSE

2 pikë Nëse rendit dy nga kërkesat e Kongresit Kombëtar të Indisë.

1 pikë Nëse rendit një nga kërkesat e Kongresit Kombëtar të Indisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 18**Model përgjigjeje**

Sipas Traktatit të Paqes me Romën në v 228 p.e.s.:

- Teuta detyrohej t'u paguante romakëve një tribut vjetor me këste.
- Të mos lundronte në jug të Lisit (Lezhës) me më shumë se dy anije të paarmatosura.
- Duhej të hiqte dorë nga pjesa më e madhe e tokave të Ilirisë.

3 pikë Nëse shkruan tre nga kushtet e traktatit të paqes.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga kushtet e traktatit të paqes.

1 pikë Nëse shkruan një nga kushtet e traktatit të paqes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19**Model përgjigjeje**

- a) Prodhimi blegtoral pësoi rënie të ndjeshme.
- b) Tregu fshatar i produkteve blegtorale dhe ushqimore pothuajse u zbraz.
- c) Fshatarët humbën interesin për punë.
- d) Vjedhjet e shumta në kooperativa.
- e) Numri i bagëtive u reduktua shume, pasi fshatarët i shitën ose i therën ato.

3 pikë Nëse jep tre nga argumentet

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga argumentet

1 pikë Nëse jep një nga argumentet

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 20**Model përgjigjeje**

Qeverisja përfaqësuese: realizohej me pëlqimin e të qeverisurve.

Federalizmi - Parlamenti përbëhej nga dy dhoma: Bundestagu që zgjidhej me votim të përgjithshëm dhe Bundesrati që përbëhej nga përfaqësuesit e landeve (shteteve) të zgjedhur nga qeveritë vendore.

Shteti social - përmbante realizimin e komponentëve të Shtetit të Mirëqenies Sociale, si garantimi i të ardhurave, sigurimet sociale, arritjen e mirëqenies së përgjithshme.

3 pikë Nëse shpjegon se si sanksionoheshin në kushtetutë tre të mësipërmet.

OSE

2 pikë Nëse shpjegon se si sanksionoheshin në kushtetutë dy nga të mësipërmet.

1 pikë Nëse shpjegon se si sanksionoheshin në kushtetutë një nga të mësipërmet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare